

MEHMET ÇELIKU

**DUKURI SINTAKSORE ME INTERES DIALEKTOR
NË GJUHËN SHQIPE**

1. Mbi kërkimet në fushë të sintaksës në fazën e parë të kërkimeve dialektore në Shqipëri.

Faza e parë e hetimit të përgjithshëm të dialekteve, që zgjati rreth 25 vjet, kishte si detyrë kryesore evidentimin e dallimeve (tipareve dalluese) të të folmeve të shqipes; në këtë fazë të parë kërkimet u përqendruan kryesisht në hulumtimin e dallimeve dialektore kryesore në sistemin fonetik-fonologjik, morfologjik e leksikor, ndërsa në fushë të sintaksës kërkimet për shumë arsye dolën në plan të dytë. Mbledhja e materialeve dialektore në gjithë territorin e vendit për studimin e dialekteve dhe të folmeve të gjuhës sonë dhe përshkrimi i tipareve kryesore e dalluese do të shërbenin për studimin e historisë së gjuhës shqipe dhe për kodifikimin shkencor të standardit, që shtrohej për zgjidhje në atë kohë. Në fushë të sintaksës mbledhja e materialit kishte specifikën e vet, ajo kërkonte hulumtime më të gjata në terren, kërkonte bazë materiale për regjistrime me magnetofon të teksteve dialektore të plota e të gjata, që me shënime në fletore, praktikë zotëruese e asaj kohe, nuk realizohej dot, kërkonte më shumë kohë e specialistë; pastaj, në fushë të sintaksës, dallimet kryesore midis dy kryedialekteve njiheshin, ato ishin të kufizuara dhe nuk përbënin ndonjë pengesë të pakapërcyeshme në ndërtimin e standardit.

Faza e parë e kërkimeve dialektologjike ishte faza e kërkimit të lëndës faktike në terren dhe e përshkrimit të saj në skicë-monografi përshkruese dalluese. Kushtëzimi i mbledhjes së materialit sipas pyetësorëve, reflektohej në hartimin e skicave me strukturë e përmbajtje të afërta; si rrjedhim, skicë-monografitë ishin të natyrës përshkruese dhe shumë të ngjashme midis tyre. Shumica dërrmuese e tyre përmbajnë krerë të njëjtë: Fonetika, Morfologjia, Leksiku dhe vetëm disa paragrafë të kufizuar për fjalëformimin dhe sintaksën.

Për këtë fazë të parë, të quajtur ‘faza e hetimit të përgjithshëm të dialekteve’, vetëm në Shqipëri punoi një sektor i tërë i përbërë nga një numër specialistësh prej gjashtë dialektologësh të kualifikuar (J. Gjinari, M. Totoni, B. Beci, M. Çeliku, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani); këtij grupi i duhen shtuar edhe emrat e disa gjuhëtarëve me përvojë, anëtarë të përkohshëm dhe bashkëpunëtorë të afërt të sektorit, si M. Domi, S. Floqi, Q. Haxhihasani, E. Lafe, Xh. Topalli, etj. si edhe disa punues të sektorëve të tjerë të IGJL a të universiteteve të vendit (J. Thomai, T. Osmani etj.), që, krahas punëve të tjera

në sektorë e institucione të tjerë, u angazhuan edhe në këtë fushë kërkimesh, si dhe një numër i madh arsimitarësh nga rrethe të ndryshme të vendit, nga të cilët do të përmendim vetëm Ç. Petritin, F. Muçën, Sh. Hoxhën. Më vonë kërkime dialektore intensive të ngjashme u shtrinë edhe në trojet shqiptare në Jugosllavi, në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, ku punuan një numër i konsiderueshëm dialektologësh, të cilët, krahas mbledhjes së materialeve, botuan studime, artikuj e monografi nga fusha e dialektologjisë, leksikologjisë dialektore e toponomastikës.

Në fazën e parë kërkimet dialektore në fushë të sintaksës nuk u anashkaluan plotësisht, nuk u injoruan. Madje edhe në pyetëtorët dialektologjikë kryesorë sintaksa zë një hapësirë të caktuar, megjithëse të kufizuar. Kështu, S. Floqi në *'Pyetësor për mbledhjen e materialit dialektor të gjuhës shqipe'* (hartuar e përdorur që nga viti 1956) pohon se "Për formimin e fjalëve dhe veçanërisht për sintaksën, puna e mbledhjes së materialit dialektor është mjaft e vështirë". Pyetëtori i Floqit përmban 20 pyetje për sintaksën, por disa dukuri të tjera me interes sintaksor mund të kapeshin edhe nëpërmjet hulumtimeve në fushë të morfologjisë, kështu shifra, sipas nesh, mund të rritet nga 20 në 30 pyetje. Gjithashtu ADGJSH përmban disa pyetje për sintaksën, që përsërisin shumë nga pyetjet e pyetësorit të Floqit. Edhe në skicë-monografitë e botuara kreu i sintaksës përmban rreth një deri dy-tre faqe, ku trajtoheshin gati të njëjtat çështje. Përveç kësaj, disa gjuhëtarë kanë botuar edhe artikuj e studime kushtuar temave të veçanta të sintaksës dialektore dhe sintaksës popullore të krijimeve folklorike (si: S. Floqi, T. Kelmendi, M. Çeliku etj.); disa autorë të tjerë kanë konstatuar e theksuar karakterin popullor të disa konstrakteve sintaksore të përdorur nga shkrimtarë të mirënjohur shqiptarë, etj.

2. Një vlerësim i përgjithshëm i dukurive sintaksore dialektore të shqipes zbuluar dhe përshkruar në fazën e parë

Arritjet e fazës së parë të kërkimeve dialektore janë të shumta e me rëndësi të veçantë, kryesisht, në fushë të fonetikë-fonologjisë, morfologjisë e leksikut për njohjen tërësore të degëzimeve dialektore të shqipes, që shërbyen për studimin e historisë së gjuhës dhe për sendërtimin e shqipes standarde. Korpusi dialektor i mbledhur në terren vuri në baza shkencore gjithë studimet në fushë të shkencave të ndryshme gjuhësore. Sigurisht, materiali i mbledhur ka pasur dhe do të ketë vlera studimore të mëdha jo vetëm për të kaluarën, por edhe për sot e të ardhmen. Këtu kemi parasysh edhe materialin e mbledhur enkas për ADGJSH.

Por në trajtimet e gjertanishme, siç është theksuar edhe nga të tjerë (M. Domi 1982), nuk ka gjetur trajtim të mjaftueshëm sintaksa dialektore; është e nevojshme për t'u gjurmuar e studiuar më shumë ky aspekt i gjuhës shqipe. Një detyrim aktual qëndron sot përpara gjuhësisë shqiptare, pikërisht puna për të mbledhur e regjistruar korpusin faktik nga fusha e sintaksës dialektore dhe për ta shpëtuar atë nga rreziku i humbjes në rrethanat e zhvillimeve të reja të

vendit. Ky front i gjerë pune kërkon jo vetëm organizim institucional, por edhe mbështetje financiare qeveritare në kuadrin e zhvillimit të shkencës, në veçanti të shkencave albanologjike.

Në fushë të sintaksës materialet dialektore që janë mbledhur më parë dhe ato të rejtat që pritet të mblidhen në të ardhmen, paraqesin interes të madh jo vetëm për tiparet dalluese, karakteristike për të folme a grupe të folmesh të veçanta, por ato kanë vlera të jashtëzakonshme sidomos për të njohur thelbin e strukturës sintaksore autentike të shqipes, e cila, siç dihet, ka një traditë shkrimore të kufizuar. Korpusi sintaksor dialektor do të shërbejë si një bazë e sigurt për të njohur origjinalitetin e shqipes si gjuhë e vjetër dhe me tipare të veçanta si dhe evolucionin e strukturave të saj në shekuj ; këto hulumtime do të shërbejnë edhe për mbrojtjen e strukturës sintaksore të shqipes standarde nga ndikimet e gjuhëve të huaja si edhe për pasurimin e mëtejshëm të saj. Kërkimet në fushë të dialektologjisë në përgjithësi, sidomos ato në fushë të sintaksës, zbulojnë jo vetëm dallimet gjuhësore midis trevave, por edhe tiparet gjuhësore e strukturat e përbashkëta të gjuhës shqipe. Në sintaksë, sidomos, gjetja e tipareve të përbashkëta ndërdialektore ka përparësi ndaj variacioneve sintaksore dialektore, që, nga ana e tyre, dëshmojnë zhvillime të mëvonshme të gjuhës për shkaqe nga më të ndryshmet, nga zhvillimet objektive të veçanta të dukurive në treva të caktuara e deri në ndikimet e huaja në zonat gjuhësore periferike.

Është i njohur fakti se dallimet sintaksore kryesore midis dy kryedialekteve të shqipes janë shumë të kufizuara në numër, ku të vetmin dallim kryesor e shënon prania e infinitivit në dialektin e Veriut (në gegërishte) dhe mungesa e tij në dialektin e Jugut (në toskërishte). Paskajorja geqe e tipit *me punue*, plotësisht e krahasueshme me infinitivin e të gjitha gjuhëve të Europës që kanë një të tillë, është e barasvlershme në toskërishte kryesisht me mënyrën lidhore të foljes dhe me një sistem mjetesh të tjera plotësuese, si gerundi me parafjalën *për* etj. Ky dallim kryesor strukturor i pranisë së infinitivit në dialektin e veriut dhe i mungesës së tij në atë të jugut dëshmohet sot nëpërmjet faktit se paskajorja e gegërishtes, ku më shumë e ku më pak, përdoret në të gjithë dialektin e veriut, përfshirë edhe të folmet kalimtare, por jo në toskërishte. Ky dallim nuk është origjinar i hershëm, por është zhvillim relativisht i mëvonshëm i gjuhës shqipe, sepse, sipas disa gjuhëtarëve, përfshirë dhe autorin e kësaj kumtese, shqipja ka pasur më herët një paskajore sintetike të përbashkët, gjurmët e së cilës ruhen shumë qartë sot e kësaj dite.

Studimet e deritanishme konfirmojnë se dukuritë sintaksore me interes dialektor kanë shtrirje e luhatje të ndryshme: disa dukuri kanë një shtrirje më të gjerë, disa takohen vetëm në një dialekt a në treva të caktuara të ngushta dialektore, në grupe të folmesh a të folme të veçanta.

Ja disa prej dukurive sintaksore me interes dialektor:

1. përdorimet e mënyrës lidhore të foljes në toskërishte e në gegërishte;

2. përdorimet e formave të pashtjelluara të foljes, të trajtave të shfaqjes së tyre dhe e disa shprehjeve të ndërtuara me to, sidomos përdorimet e paskajores së gegërishtes dhe të ndërtimeve me trajtat e gerundit në toskërishte por edhe në gegërishte;

3. përdorimi i mënyrave habitore e dëshirore të foljeve;
4. sistemi rasor i emrave/përemrave, i lidhur ky me sistemin parafjalor;
5. kategoria e shquarsisë dhe e pashquarsisë së emrave e përdorimi i emrave të pashquar/të shquar në shqipe;
6. rendi i disa fjalëve e përbërësve sintaksorë (sintagmave) në fjali;
7. ndërtimet sintetike dhe ndërtimet analitike (me parafjalë);
8. ndërtimet pa lidhëza dhe ndërtimet me lidhëza në fjali të thjeshta e të përbëra, etj.

Këto dukuri të përgjithshme, disa nga të cilat janë hulumtuar dhe botuar në produkte dialektologjike nga dialektologët gjatë fazës së parë të kërkimeve dialektore, pasqyrojnë një variacion sintaksor të kufizuar midis dialekteve e midis të folmeve të shqipes.

Ja disa dukuri konkrete në fushë variacionit dialektor të konstatuara e të përshkruara nga disa dialektologë:

1. Përshtatja në numër kryefjalë/kallëzues e emrave kolektivë (*botë flasim/flet*), ose përshtatja e emrave në njëjës në funksion të kryefjalës me foljen kallëzues në lidhore shumës (**t'marrin/t'marri faqe toka; t'dalin/t'dali rakia**);

2. ndryshimi/ mosndryshimi i gjinisë së emrave me e në shumës (**male të lartë / të larta**) dhe përshtatja/ mospërshtatja në gjini e numërorit **tre/tri (tri/tre vajza)**;

3. rasat e emrave dhe të përemrave të paraprirë nga parafjalë të ndryshme, përdorimi i formës rasore vendore të emrave me mbaresën -t, përdorimi i rasës kallëzore në vend të dhanores/rjedhores të parapirë nga parafjalë të ndryshme, parafjalët dhe marrëdhëniet e ndryshme sintaksore të shprehura me to, përdorimi i strukturave pa parafjalë në vend të atyre me parafjalë (**një thes grurë / një thes me grurë; ju mushën syt lot / syt me lot; po shkoj Durrës/ po shkoj në Durrës**);

4. strukturat me parafjalët *nga / prej*;

5. përdorimi i rasës rrjedhore të pashquar / të shquar (*mish gjeli dhe: mish gjelit, qymyr ahit, lug drunit, ksoll furret*), dukuria e elizionit të mbaresave të përparme tek emrat e mbiemrat; dukuria e shfaqjes së mbaresës së përparme për të treguar banorin e një vendi (**I shkrel, I hot, I kastrat, I shkodran**);

6. përdorimi i pashquar / i shquar i emrave pas disa parafjalëve (kena met **me Dajç/Dajçin**);

7. rendi i disa fjalëve të caktuara, si p.sh. vendosja e pjesëzës *mos*, i trajtave të shkurtra të përemrave, i foljeve ndihmëse, përdorimet e mënyrave lidhore, habitore etj.

Por, për mendimin tonë, disa prej këtyre dukurive nuk kanë interes dialektor (siç është rasti i përshtatjes në numër midis kryefjalës e kallëzuesit **bota flasin/flet**, i ndërrimit të gjinisë së emrave në shumësin me **e (punime të mira, këto male)**; i mospërshtatjes në gjini i numërorit **tre/tri** me emrin, ndoshta, edhe ai i elizionit të mbaresave etj.), por janë dukuri me interes të përgjithshëm gjuhësor, luhatje që takohen në zona të ndryshme dialektore, madje edhe tek përdoruesit e standardit, që dëshmojnë përshtatje të konceptuara në moment ose dëshmojnë zhvillime analogjike a prijje të caktuara në gjuhë, pa një shtrirje territoriale krahinore qartësisht të përvijueshme.

3. Për një gjurmim e studim më të thelluar të sintaksës dialektore

Dialektologjia shqiptare si disiplinë gjuhësore e veçantë synon aktualisht të realizojë korpusin faktik të sintaksës dialektore, çka do ta pasurojë më tej traditën e saj në mbledhjen e materialeve dialektore sistematike në trevat kryesore të vendit. Regjistrimi elektronik i korpusit dialektor do të përbënte një ndërmarrje të re të pazëvendësueshme dhe urgjente me vlera të mëdha për studimet e mëtejshme të thelluara të strukturës gramatikore-sintaksore të shqipes, veçanërisht të historisë së saj, objektiv që mund të realizohet duke u mbështetur kryesisht në lëndën gjuhësore dialektore.

Materialet në fushë të sintaksës dialektore duhen mbledhur e regjistruar pa humbur kohë. Në rrethanat e zhvillimit të shoqërisë shqiptare, të lëvizjeve, të kontakteve, të zhvillimit të arsimit e të kulturës, të ndikimit të standardit, të rrallimit të natyrshëm të subjekteve shqipfolës të brezit të vjetër, koha që po kalojmë, përbën rastin e përshtatshëm dhe të fundit që shkencës albanologjike i jepet për ta kryer këtë mision.

Faza e parë e punës në fushë të kërkimeve sintaksore, për mendimin tonë, i përket mbledhjes së korpusit sintaksor dialektor si për dukuritë sintaksore të përbashkëta, ashtu edhe për ato dallueset. Kërkohet një punë organizuese e kujdeshme, duke filluar me hartimin e kriterëve të mbledhjes e regjistrimit të korpusit faktik të sintaksës dialektore, siç janë: përcaktimi i rrejtit të pikave të banuara përfaqësuese të të folmeve të vendit, i numrit të subjekteve sipas brezave e gjinisë, i kohëzgjatjes së regjistrimeve të bisedave me përparësi, i bisedave të lira e të orientuara, i temave të bisedave, i përgatitjes së specialistëve dhe i bazës teknike etj. Regjistrimet në terren, kombinuar me regjistrimet në qendra institucionale, në institute a në universitete, do të kryhen nga disa gjuhëtarë, pedagogë a dialektologë të rinj të përgatitur si dhe nga disa teknikë të fushës regjistruese, që do të përdorin aparate regjistrimi (incizimi) cilësore. Hartimi i kriterëve, përgatitja e teknikëve e specialistëve dhe i bazës materiale dhe sidomos regjistrimi i materialeve dhe zbardhja e tyre, shoqëruar

me shënime e komente shkencore, përbën një ndërmarrje disavejeçare dhe një bashkëpunim forcash shkencore e teknike mbarëkombëtare. Materialet e korpusit faktik dialektor sintaksor do të përbënin një degë të veçantë të Kartotekës së Dialektologjisë, atë të sintaksës dialektore apo fonotekës sintaksore. Materialet e incizuara duhen zbardhur në disa kopje dhe duhen studiuar e shoqëruar me shënime nga gjuhëtarët specialistë. Pikat e eksploruara këtë radhë do të ishin mjaft të reduktuara, përfaqësuese tipike të të folmeve a grupeve të të folmeve të dy dialekteve, brenda dhe jashtë Shqipërisë; në radhë të parë, siç u tha, do të synohet të kapen jo dallimet e veçanta, por të përbashkëtat e strukturave të shqipes, përfshirë dallimet themelore. Natyrisht, materialet ekzistuese të regjistruara më parë nga autorë të ndryshëm në Shqipëri e jashtë Shqipërisë etj. kanë interes të madh e duhen mbledhur, duke gjetur mënyrat për t'ia atashuar korpusit faktik të përbashkët. Për nevojën e ngritjes së një fonoteke dialektore është folur edhe më parë. M. Domi ka theksuar: “Regjistrimi me magnetofon i materialeve dialektore në vitet e ardhshme do të zhvillohet në përmasa më të mëdha, me synime më të përcaktuara ... për ngritjen e një fonoteke të veçantë dialektore të pasur që do të vijë duke u plotësuar gjithnjë. Në bazë kriteresh e synimesh të përcaktuara mirë e të një plani perspektiv, do të shtjellohet një punë sistematike, me anë të së cilës do të krijohet arkivi fonogramik tërësor i dialektologjisë sonë, që do të përbëjë bazën objektive të nevojshme për studimet e ardhme, qoftë përshtuese e analitike, qoftë problemore e përgjithësuese, qoftë krahasuese e historike. Me fondin e pasur të teksteve dialektore, ai në mënyrë të veçantë do të japë mundësi të saktësohen sa më shumë vëzhgimet mbi dukuritë e veçanta fonetike të të folmeve të ndryshme, të njihet mirë sintaksa dialektore, në përgjithësi sintaksa popullore, duke hapur perspektiva të reja për studimet e mëtejshme dialektore e gjuhësore të tjera”. (M. Domi, Dialektologjia Shqiptare, IV, 1982, fq. 14)

Korpusi faktik sintaksor dialektor, regjistruar e zbardhur, do të shërbejë më vonë, në **një fazë të dytë të punës**, për studime përgjithësuese të thelluara në të ardhmen, individuale a me bashkautorë. Studimet do të sqarojnë e dokumentojnë shumë gjëra që sot për sot nuk janë të qarta: ne sot dimë që në gegërishte përdoren edhe paskajorja e tipit *me punue* edhe *lidhorja*, por nuk njohim mirë përdorimet sintaksore të tyre, dendurinë e përdorimit të tyre, nuk njohim të gjitha strukturat tipike të përdorimit të tyre në treva të ndryshme, të paskajores së pavarur, të strukturave folje modale a aspektore + paskajore; ne dimë se në toskërishte përdoren edhe lidhorja edhe gerundi me parafjalën *për*, por nuk dimë përdorimet karakteristike të lidhores në treva dialektore të ndryshme, përdorimet e lidhores përgjithësuese, që zëvendëson infinitivin, shkallën e përdorimeve të gerundit si gjymtyrë të fjalisë etj.; nuk dimë shkallën e përdorimit të përcjelloreve pohore e mohore, kuptimet e përdorimit e tyre; nuk dimë përdorimet e gerundit të tipit *me + të punuar*, *një + të punuar*; *së*

punuari etj.; gjithashtu materialet e regjistruara të bollshme do të mundësojnë studimin e tipave të përbërësve sintaksorë, strukturën e tyre, caktuesorët e përbërësve, përbërësit e zbërthyeshëm të lidhur drejtpërdrejtë dhe ata që lidhen me parafjalë, si dhe studimin e funksioneve sintaksore të përbërësve, tipat e fjalive të thjeshta, studimin e fjalive në ligjërim (thëniet); korpusi do të mundësonte studimin e fjalive të përbëra pa lidhëza (asindetet) dhe fjalitë e përbëra lidhëzore nënrenditëse e bashkërenditëse etj. Fonoteka e korpusit sintaksor dialektor do të jetë një bazë faktike shumëfunktionale që do të shërbejë për tema të tilla interesante, siç janë intonacioni, rendi, theksi i thënies etj.

Siç shihet, gjithë puna konceptohet prej nesh në dy faza konkrete: 1) Faza e mbledhjes së korpusit sintaksor dialektor dhe e krijimit të fonotekës sintaksore dialektore, e krahasueshme me kartotekat ekzistuese të leksikologjisë dhe kartotekën e gramatikës së shqipes standarde, dhe 2) Faza e studimeve dialektologjike sintaksore mbështetur mbi korpusin faktik sintaksor dialektor të regjistruar në fazën e parë.

Gjithë kjo punë kërkon kohë, organizim të mirë institucional, mbështetje financiare, bashkëpunim midis instituteve shkencore mbarëkombëtare (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi) dhe universiteteve të ndryshme. Kohëzgjatja e kësaj veprimtarie hulumtuese natyrisht do të jetë më e shkurtër se ajo e studimit të fushave të tjera (fonetikë, morfologji e leksik). Specifikat e sintaksës e rrethanat aktuale e bëjnë të panevojshëm hartimin e një pyetësi me pyetje nga fusha e sintaksës e sidomos mbledhjen e korpusit sintaksor sipas një pyetësi të tillë. Çështjet e ngritura më sipër prej nesh dhe shumë të tjera kërkojnë diskutime të hapura paraprake nga bota shkencore shqiptare gjithëkombëtare dhe marrjen e përvojës ndërkombëtare.

Konferenca shkencore e organizuar nga IGJL të ASHSH shënon hapin e parë në këtë ndërmarrje. Ajo kërkon mbështetje nga të gjitha shkollat e larta të trevave shqiptare, ajo kërkon bashkëpunim të sektorëve e departamenteve të filologjisë shqiptare dhe më gjerë, ajo do të shtrojë e do të sqarojë shumë probleme e detyra që dalin sot para albanologjisë.

BIBLIOGRAFI

- ASHSH, IGJL, *Atlasi Dialektologjik i gjuhës shqipe*, Universita degli Studi di Napoli L'Orientale, vëllimi I 2007; vëllimi II, 2008.
- Badallaj, I., *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001.
- Beci, B., *E folmja e Shkrelit*, në "Dialektologjia Shqiptare", I, Tiranë, 1971.
- Çeliku, M., *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2013 (botim i katërt).

- Çeliku, M., *Gegërishtja jugperëndimore*, disertacion për gradën ‘Kandidat i shkencave’, 1980, 263 faqe (e pabotuar).
- Domi, M., *Gjendja, probleme dhe detyra të dialektologjisë shqiptare në fazën e sotme*, në “Dialektologjia shqiptare”, IV, Tiranë, 1982, f. 3-20.
- Floqi, S., *Pyetësor për mbledhjen e materialit dialektor të gjuhës shqipe*, në “Dialektologjia shqiptare”, I, Tiranë, 1971, f. 371-447.
- Floqi, S., *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, në BUSHT, SSHSH, 3, Tiranë, 1958.
- Gjinari, J., *Gjendja dhe perspektiva e dialektologjisë shqiptare*, në “Dialektologjia shqiptare”, I, Tiranë 1971, f. 9-27.
- Gjinari, J., *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, në “Dialektologjia Shqiptare”, I, 1971.
- Haxhihasani, Q., *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*, në BUSHT, SSHSH, 1963, 4, f. 116-164.
- Kelmendi, T., *Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën popullore shqipe (sipas folklorit)*, (punim magjistrature), Prishtinë, 1980.
- Raka, F., *E folmja e qytezës së Kaçanikut*. “Studime gjuhësore”, Prishtinë, 1978.
- Shkurtaj, Gj., *E folmja e Hotit*, në “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974.
- Topalli, Xh., *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, në “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974.
- Totoni, M., *E folmja e Zagorisë*, në BUSH T, SSHSH, 1, 1962.
- Totoni, M., *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në “Dialektologjia Shqiptare”, I, Tiranë, 1971.

SUMMARY

SYNTACTIC FEATURES OF DIALECTICAL INTEREST IN ALBANIAN

This article consists of two parts. In the first part, it provides a thorough overview of the history of the study of Albanian dialect syntax, focusing on the reasons that motivated it, as well as the methodological barriers that it faced over years. The first phase of dialectological study, which lasted about 25 years, was motivated largely by the need to determine the features that differentiate the two major dialects of Albanian and their geographical distribution. During this phase, work focused mainly in the domains of phonetics-phonology, morphology and lexicon. Syntax was left behind due to various methodological barriers connected with the lack of equipment. In addition, scholars believed that differentiating features in syntax were so small

in number that they did not present any obstacle for the creation of the standard variety, which was the major goal of the Albanology during that time.

The second part attempts to generalize a set of criteria for the selection of dialect syntax features to be followed in future studies. Specifically, this section first provides some examples of features that are specific to various dialectical variants, and features that are more common across differing dialectical variants. Secondly, it argues that dialectical features that have spread into the standard variety are not worth investigating as features that do not pertain specific dialectical information. This part also suggests that data collection should happen in not as many geographical points as in the case of the Dialectological Atlas of Albanian, but in a reduced set due to the fact that syntactic microvariation is not as varied as phonological and lexical variation.

